



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/04-4932/25, më 10 JAN 2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë

V E N D I M

1. Miratohet ndryshimi i Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 14-030/01-21504/24 i dt. 08 Shkurt 2024.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, bëhet ndryshimi i nenit 1, paragrafi 1.2 të Vendimit, respektivisht ndarja e Drejtorisë së Pronës dhe Kadastrit, në dy drejtori të ndara nga njëra tjetra, ashtu që këto dy drejtori tani emërtohen:
 1. Drejtoria e Pronës;
 2. Drejtoria e Kadastrit.
3. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen dispozitat e Vendimit nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016 të cilat bien në kundërshtim me këtë Vendim.
5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Drejtorisë së Pronës dhe Kadastrit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

